



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:208142

Datë: 31.05.2024

Numri i dokumentit: 05766347

KF.nr.415/2022

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtaren Vera Gashi Bala, në kontestin tregtar - administrativ të paditësit “Kushtrimi O.P.” me seli në Malishevë, rr. “Adem Jashari”, p.n. të cilin me autorizim e përfaqëson Rrahman M. Kastrati, avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Dogana e Kosovës, me seli në Prishtinë, lidhur me padinë e paditësit për anulimin e vendimi, objekt kontesti rivlerësim doganor, vlera e kontestit 851.96 euro, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor-publik, të mbajtur me datë 16.05.2024, në prani të përfaqësuesit të autorizuar të palës paditëse avokat Rrahman Kastrati dhe përfaqësuesit të palës së paditur, Krenare Shala, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. Aprovohet kërkesëpadia e paditësit “Kushtrimi O.P.” me seli në Malishevë, si e bazuar.
- II. Anulohet aktvendimi nr.01.3.2.2/10346/2019, i datës 27.08.2021, i Doganës së Kosovës, me seli në Prishtinë.
- III. Obligohet e paditura Dogana e Kosovës me seli në Prishtinë, që paditësit “Kushtrimi O.P.” me seli në Malishevë, t’ia pranoj vlerën e transaksionit të paguar në emër të faturave për mallin lëndor të paraqitur për zhdoganim sipas DUD-ave kontestues nr.: R- 8404/29.07.2019 dhe R-8425/29.07.2019, të proceduara në ZBD Merdare, dhe t’ia kthejë mjetet e paguara më tepër paditësit në emër të taksave doganore importuese në vlerë prej 851.96 euro (tetëqind e pesëdhjetë e një euro e nëntëdhjetë e gjashtë cent), me kamatë ligjore prej 8 % nga data 29.07.2019 e deri në pagesën definitive.
- IV. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedural.

## A r s y e t i m

Paditësi me padinë e paraqitur në Gjykatë, me 17.09.2021, ka iniciuar kontestin tregtar-administrativ kundër të paditurës Dogana e Kosovës, me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit nr. 01.3.2.2/10346/2019 të datës 27.08.2021. Si në padi ashtu edhe në seancë gjyqësore deklaroi se në tërësi ngelet pranë padisë së parashtruar në të gjitha thëniet në tekstin e padisë duke e njoftuar gjykatën edhe një herë se objekti i kësaj padie njëherë është shqyrtuar në Departamentin Administrativ të Gjykatës ku është aprovuar kërkesëpapia e paditësit dhe lënda është kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje me sugjerimet e dhëna nga gjykata se si duhet të veprojë e paditura me marrjen e vendimit tjetër, mirëpo e njëjta si në procedurën e parë përsëri ka vendosur njëjtte, pa zbatuar asnjë sugjerim të gjykatës. Më tej ka shtuar se e ka pranuar përgjigjen në padi nga ana e të paditurës e cila përgjigje në esencë nuk ka asnjë përmbajtje përveç se kërkon që të refuzohet kërkesëpapia e paditësit. Gjithashtu ka shtuar se sipas nenit 33 par 1 i KDA thuhet se vlera doganore e mallrave të importuara është vlera e transaksionit, që paraqet çmimin e vërtetë të paguar ose të pagueshëm... Faturat, para faturat dhe të gjitha pagesat nga ana e paditësit janë kryer konform kësaj dispozitë. Metoda e zhdoganimit me metodë krahasuese nuk ka mund në asnjë mënyrë të vie në shprehje. Kërkesëpadinë e ka precizuar lidhur me pikën tre të petitumit ku thuhet: detyrohet e paditura që të pranojë vlerësimin e mallrave lëndor sipas nenit 33 të KDA ashtu që paditësit t'ia kthej shumën prej 617.33 euro për DUD R 8425 dhe për DUD R 8404 shumën prej 234 euro, me kamatë ligjore prej 8% nga data 29.07.2019.

E paditura, në përgjigjen në padi të datës 05.04.2022 e ka kundërshtuar në tërësi padinë si të pabazuar. Tutje ka theksuar se aktvendimi i atakuar është marr konform të gjitha dispozitave në fuqi dhe ajo në të cilën pretendon pala se ky vendim është nxjerr me shkelje ligjore nuk qëndron fare, me arsyetimin se vendimi i atakuar është marr konform legjislacionit në fuqi dhe në mënyrë të drejtë, ndërsa pala paditëse pretendimet e veta nuk i ka vërtetuar as edhe me një provë të vetme. Gjatë seancës së shqyrtimit kryesor e paditura e konteston në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë si të pabazuar. Thekson se e paditura në rivendosje ka analizuar gjithë dokumentacionin e lëndës dhe ka konstatuar se në shkresat e lëndës mungon kontrata e shitblerjes për dy importe lidhur me çmimin e këtyre mallrave, po ashtu transaksioni bankar i realizuar me dt 15.07.2019 në vlerë 17,984.30 është

realizuar në emër të pro faturave me nr. 482, 481 dhe 483 ndërsa malli kontestues është doganuar me fatura nr. E70484 dhe E70482. Pra ky transaksion bankar Dogana nuk mund ta merr për bazë si të vlefshëm pasi që paditësi nuk ka arritur të dëshmojë që vlera e deklaruar është vlerë reale e transaksionit, gjithnjë duke pasur parasysh se vlerësimi i mallit është bazuar në metodën e tretë të vlerësimit neni 34 par 2 i KDA-së, respektivisht në bazë të dhënave të disponueshme të Doganës së Kosovës. Dokumentet e cekura nga paditësi nuk janë të bashkangjitura as në sistemin ASYCUDA as në procedurën e rivendosjes dhe Dogana e Kosovës ka bërë vlerësimin e provave që ka prezantuar paditësi me provat që kanë shërbyer për referencë të vlerësimit të mallit duke pasur parasysh se dogana disponon me mallra të ngjashme të shitura për Kosovë dhe të eksportuara në të njëjtën kohë ose përafërsisht për mallrat që janë duke u vlerësuar, pasi që janë evidentuar importues tjerë që në periudhë afërsisht të njëjtë me mallin që është vlerësuar, mallin e ngjashëm nga i njëjti eksportues dhe i njëjti shtet i origjinës dhe të cilat kanë vlerë më të lartë të mallit kontestues. I propozon gjykatës që të marrë aktgjykim me të cilin refuzohet në tërësi si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit dhe duke lënë në fuqi aktvendimin e të paditurës.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit gjyqësor kryesor - publik të datës 16.05.2024, ka administruar provat si në vijim: Vendimi kontestues 01.3.2.2/10346/2019 dt. 27.08.2021, Aktgjykimi A.nr. 2477/19, Deklaratat eksportuese, DUD R-8425; R-8404, Faturat me nr. E 70484, E 70482, Pro faturat me nr. 483,482, 481, Transaksioni bankar dt. 15.07.2019,Procesverbal mbi përcaktimi e vlerës së mallrave dt. 30.07.2019, Provat referente: DUD R 27193, R 30244, R 17542, R29533, R23976, R33606, Aktvendim 01.3.2.2/10346 dt 11.09.2019.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thënieve në padi, përgjigjes në padi, shkresave të lëndës në këtë konflikt administrativ, bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave se bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë konflikt administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga provat e administruara në këtë konflikt administrativ, Gjykata nga DUD-at kontestues të të paditurës, deklarimeve në ankesë, si dhe aktvendimi kontestues ka nxjerr konstatimin se paditësi

ka deklaruar mallin për zhdoganim, me ç'rast pas pranimit dhe vlerësimit të DUD-ve kontestues, e paditura ne bazë të të dhënave të disponueshme nga Dosja e Vlerës të dhëna të cilat janë krahasuar me mallin lëndor kontestues ka bërë rivlerësimin e mallit me metodën e tretë (3) të vlerësimit në pajtim me nenin 34.2 pika b) të KDA-së, respektivisht ne bazë të dhënave të disponueshme, dhe paditësi është detyruar që të paguaj taksen doganore me të lartë se të deklaruar me faturën e mallit.

Në arsyetimin e vendimit kontestues me të cilin është refuzuar ankesa e paditësit, e paditura theksohen se Dogana e Kosovës në rivendosje konstaton se Sektori i Kontrollës Pas Importuese-Njësi i Inspektimit Pas Zhdoganimit ka vepruar drejtë kur ka konstatuar vlerën e mallit lëndori si në deklaratat unike doganore kontesteuese pasi që vlera e mallit e deklaruar për zhdoganim nuk është vlera reale e paguar për mallin me qëllim importi në vendin tonë për arsye se është deklaruar vlerë më e vogël se sa vlera reale e paguar apo që ka për tu paguar për mallin e shitur për eksport përkatësisht import në vendin tonë në vështrim të nenit 33 të KDAK-së.

Gjykata konstaton se e paditura nuk ka vepruar konform vërejtjeve dhe obligimeve të dhëna në aktgjykimin A.nr.2477/19, me të cilin e paditura ishte obliguar që ne rishqyrtim dhe rivendosje, te deklarohet lidhur provat te cilat i ka bashkangjitur paditësi kësaj lënde lidhur me faturën dhe transaksionin bankar si dhe të konstatoj këto pretendime dhe argumente të paditësit, dhe si rrjedhoje pas konstatimi të kësaj gjendje faktike të marr vendim të drejtë dhe të bazuar në dispozitat ligjore të KDA-së.

Nga provat e administruara, Gjykata konstaton se paditësi ka paraqitur dokumentacionin valid që dëshmon për çmimin e paguar, e paditura nuk ka arritur me asnjë provë që të dëshmoj se paditësi i ka paguar eksportuesit mbi çmimin e faturës së mallit, për të dëshmuar konstatimin e dhënë se vlera e mallrave të deklaruar për zhdoganim nuk është vlera reale e mallit.

Gjykata konstaton se aplikimi i metodës së 3 të vlerësimit në vështrim të nenit 34.2 pika b) te Kodit Doganor dhe te Akcizave, është veprim i cili bie ndesh me dispozitat e nenit 33-35 te Kodit Doganor dhe te Akcizave nr.03/L-109, për arsye, se para se të aplikohet metoda e fundit e vlerësimit gjegjësisht metoda e 3 e vlerësimit, duhet te jepen arsyet dhe provat për ta kontestuar vlerën e mallit lëndor.

Gjykata nga shkresat e lëndës vlerëson se me asnjë provë nuk është provuar konstatimi i të paditurës i dhënë në vendimin e kontestuar, sipas të cilit vlera e deklaruar e mallit lëndor nga paditësi, nuk është vlera reale e paguar e mallit me qëllim importi në vendin tonë në vështrim të nenit 33 të KDAK-së. Gjykata konsideron se e paditura do të mund ta mbështeste një konstatim të këtillë vetëm atëherë kur do të mund të siguronte dëshmi konkrete se paditësi për mallin lëndor kontestues, i ka paguar eksportuesit mbi çmimin neto të faturës të mallit, ku vlera e mallit në pro faturat me nr.482,481 dhe 483 rezulton të jetë paguar nga paditësi përmes transaksionit bankar ndërkombëtar të datës 15.07.2019, në emër të profaturave dhe e cila përputhet plotësisht lidhur me shumën, dhe përfituesit si në faturë.

Gjykata konstaton se fakti që e paditura ka në dispozicion të dhëna të tjera që tregojnë një vlerë më të lartë për mallin e importuar nga ajo e deklaruar nga paditësi, nuk përbën bazë ligjore për rivlerësimin e mallit dhe caktimin e një baze të re doganore. Sipas nenit 31, paragrafi 1 të KDAK-së, nuk kërkohet që vlera doganore e mallrave të importuar të përputhet me atë të përcaktuar në Dosjen e Vlerës “*Vlera doganore e mallrave të importuara është vlera e transaksionit, që paraqet çmimin vërtetë të paguar ose të pagueshëm për mallrat e shitura për eksport në Kosovë, i përshtatur, sipas nevojës, në përputhje me nenet 36 dhe 37*”. Ndërsa në paragrafin 3 të nenit 33 të KDAK-së është parashikuar që “*Çmimi vërtetë i paguar apo i pagueshëm është pagesa e plotë e bërë ose që duhet bërë nga blerësi për shitësin ose në dobi të këtij të fundit për mallin e importuar dhe që përfshin të gjitha pagesat e bëra ose që duhen bërë, si kusht i shitjes së mallrave të importuara nga blerësi për shitësit, ose nga blerësi për një palë të tretë për ta përmbushë obligimin ndaj shitësit. Pagesa mund të mos bëhet patjetër në formën e transferit të parave. Pagesa mund të bëhet me anë të letrave të kredisë ose ndonjë mjeti tjetër të dakorduar të pagesës dhe mund të bëhet drejtpërdrejt ose në mënyrë të tërthortë*”.

Se cili dokument duhet ti bashkëngjitet deklaratës doganore, është përcaktuar me nenin 123 par. 1 pika (a) të UA nr.11/2009 për Implementimin e Kodit Doganor dhe Akcizave nr.03/L-109, me të cilin përcaktohet se dokumenti që duhet bashkëngjitur deklaratës doganore për vendosje në qarkullim të lirë të mallit, është “*fatura në bazë të së cilës deklarohet vlera doganore e mallrave, siç kërkohet sipas nenit 91 të këtij akti*”.

Gjykata konstaton se në rastin konkret paditësi ka paraqitur profaturat e mallit lëndor nr.482, 481 dhe 483 dhe të njëjtat janë paguar nga paditësi përmes transaksionit bankar ndërkombëtar të datës 15.07.2019, në emër të profaturave e që përputhen në tërësi me shumën e profaturave dhe faturave nr. Faturat me nr. E 70484, E 70482.

Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se të gjitha këto dokumente rezultojnë të jenë të harmonizuara në tërësi sa i përket vlerës së mallit të importuar nga paditësi në kuptim të nenit 33 par.1 të KDAK-së.

Prandaj, nga gjendja faktike e vërtetuar më lartë, Gjykata përfundimisht cilëson se pretendimet e paditësit janë plotësisht të bazuara dhe të drejta dhe se dokumentacioni i prezantuar është i pa kontestueshëm nga pikëpamja ligjore për zhdoganimin e mallit lëndor, konform nenit 33 par.1 të Kodit Doganor dhe të Akcizave nr.03/L-109.

Andaj, gjykata duke vepruar në përputhje me dispozitat e nenit 292 pika b, të KDAK-së nr.03/L109, nenit 46 paragrafi 4 dhe 5 të Ligjit nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative, aprovoi kërkesëpadinë e paditësit, e anuloi vendimin e kontestuar të paditurës dhe e detyroj të paditurën që paditësit t’ia kthej shumën prej 851.96€, (tetëqind e pesëdhjetë e një euro e nëntëdhjetë e gjashtë cent), të paguar më tepër në emër të detyrimeve doganore, për shkak të rivlerësimit të mallit të zhdoganuar përmes Deklaratës Unike Doganore me nr. DUD R 8425 dhe DUD R 8404, të proceduar në Zyrën e Brendshme Doganore Merdare me kamatë ligjore prej 8% nga data 29.07.2019 e deri në pagesën definitive të kësaj shume, shumë e cila nuk u kontestua as na përfaqësuesja e paditëses e cila në seancë deklaroi se shuma e paguar më tepër siç është kërkuar në precizim të kërkesëpadisë nga paditësi, është e saktë, respektivisht është 851.96 euro.

Lidhur me kamatën gjykata ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit, duke pasur parasysh dispozitën e nenit 292 pika b) (i), të KDAK-së nr.03/L-109, ku parashihet “*Në rast se çështja zgjidhet përfundimisht në instance të fundit sipas mjetit të ushtruar në favor: Të Apeluesit, Dogana duhet që: (i) të rikthejë çdo detyrim të importit apo eksportit të paguar më tepër bashkë me kamatën e grumbulluar deri në momentin e zgjidhjes së kontestit nëse është e aplikueshme*” dhe dispozitat

ligjore të nenit 170 të Ligjit nr.04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, i cili përcakton se Detyrimi i shpërblimit të dëmit konsiderohet se ka arritur, për pagesë që nga momenti i shkaktimit të dëmit dhe nenit 382 paragrafi 2 të këtij ligji sipas të cilit Lartësia e kamatëvonesës është tetë për qind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë, ndërsa lidhur me datën e rrjedhës së kamatës është marrë data 29.07.2019, si datë e paraqitjes së ankesës në Doganën e Kosovës.

Gjykata i ka vlerësuar deklaratimet dhe provat tjera materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës, por erdhi në përfundim se të njëjtat janë pa ndikim në vendosjen ndryshe të kësaj çështje juridike administrative.

Vendimi që secila palë ti bart shpenzimet e veta procedurale është marrë konform nenit 64, të LKA-së.

Nga sa u tha më lart, gjykata konform me nenin 46 par. 2, 4 dhe 5 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS  
Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal  
KF.nr.415/22, datë 16.05.2024

Gjyqtarja  
Vera Gashi Bala

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj Gjykate.